



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:264538

Datë: 22.10.2024

Numri i dokumentit: 06335047

C-IV-22-0122

Ankuesi:

F K nga f.sh M K.Kamenicë.

Kundër

Pala kundërshtare:

N.SH “Kosova Trans”, të cilën e përfaqëson **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Dr.sc. Murat Hulaj, me dt.21 tetor 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. APROVOHET pjesërisht** ankesa dhe **NDRYSHOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.GJI109-0042 i dt.18 korrik 2013.
- 2. OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankuesit F K në emër të kompensimit për paga të papaguara t’i paguaj **shumën prej 1,911.65€**.
- 3. Shuma e aprovuar** si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit. Ndërsa shumat tjera të kërkuara përtej pikës 2 të këtij dispozitivi **REFUZOHEN si të pa bazuara**.
- 4. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.26 gusht 2013, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës ka pranuar ankesë nga ankuesi kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së GJI109-0042 të datës 18 korrik 2013. Parashtruesi kërkon nga gjykata që të rishqyrtoj vendimin e AKP-së dhe të obligohet e paditura që t’ia paguajë pagat e papaguara në shumë prej 2.565.68€ për periudhën kohore shtator dhjetor 2002, janar - mars 2003, prill, 15 maj-dhjetor 2004 dhe janar-shtator 2005. Kësaj ankese Parashtruesi si provë i ka bashkëngjitur: Kopjen e letërnjoftimit; Kopjen e vendimit të Autoritetit të Likuidimit GJI109-0042 i datës 18 korrik 2013; Kopjen e kartelës për ndihmë sociale; Kopjen e njoftimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 24 mars 2006; Kopjen e vendimit të

Agjencisë për Ndhimi Juridike Falas nr. 114/13 të datës 22 gusht 2013; Kopjen e aktvendimit për pushim vjetor të datës 24 mars 2003; Kopjen e kontratës si punës nr. 179 të dt.12 qershor 2002; Kopjen e kërkesës për lirim nga taksa e parashtruar nga Agjencia për Ndhimi Juridike Falas dt.22 gusht 2013.

Me dt.20 janar 2014 gjyqtari i Dhomës së Posaçme i ka dërguar paditësit një urdhër me të cilin ka kërkuar që brenda 15 ditëve nga pranimi i tij të dorëzojë: Autorizimin për përfaqësues ligjor, Kërkesë për ndihmë juridike, Përkthimin e dokumenteve dhe Dëshmi, prova shtesë për të mbështetur pretendimet e tij të parashtruara në ankesë. Në bazë të fletëkthesës e cila gjendet në shkresa të lëndës gjykata vëren se më 6 shkurt 2014 paditësi e ka pranuar urdhrin e gjykatës dhe dorëzoi: Dokumentacionin e përkthyer, Autorizimin për përfaqësim, Kopjen e kartelës për ndihmë sociale, Deklaratën për mjete financiare.

Me dt.27 qershor 2014 AKP-ja dorëzon mbrojtjen e saj ndaj ankesës së parashtruesit të dorëzuar më dt.26 gusht 2013 kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit GJI109-0042 të datës 18 korrik 2013 të NSH "KOSOVATRANS". AKP-ja përmes mbrojtjes së saj kërkon nga Dhoma e Posaçme që të refuzojë ankesën si të papranueshme dhe/ose të pabazuar, dhe të vërtetojë (lë në fuqi) Vendimin e Autoritetit të Likuidimit GJI109-0042 të datës 18 korrik 2013.

Bashkë me mbrojtjen e saj AKP-ja ka dorëzuar në gjykatë: Kërkesën për ndërrimin e Anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit të NSH-së.

Në vlerësim të këtyre provave gjykata vendos që kërkesën e ankuesit për lirim nga taksa gjyqësore, në përputhje me nenin 8.3.2 të Udhëzimit Administrativ të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, ta aprovojë si të bazuar.

Më dt.09 korrik 2014 gjyqtari i Dhomës së Posaçme i ka dërguar një urdhër Parashtruesit që në afat prej 30 ditëve nga pranimi i urdhrin të dorëzojë në gjykatë përgjigje ndaj mbrojtjes së AKP-së. Më dt.04 gusht 2014 paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar ka dorëzuar në gjykatë përgjigjen e vet ndaj mbrojtjes së AKP-së duke qëndruar pranë pretendimeve të tij. Bashkë me përgjigje ka dorëzuar: Kopjen e Formularit me kërkesë për pagat e papaguara, Kopjen e Vërtetimit të NSH-së për pagat e papaguara.

Më dt.18 gusht 2014 gjyqtari i Dhomës së Posaçme i ka dërguar një urdhër AKP-së që në afat prej 15 ditëve nga pranimi i urdhrin të dorëzojë në gjykatë kundërpërgjigje ndaj përgjigjes së paditësit.

Më dt.9 shtator 2014 AKP-ja dorëzoi kundërpërgjigjen e vet ndaj përgjigjes së parashtruesit të dorëzuar më 4 gusht 2014 dhe përsërit kërkesën e vet drejtuar Dhomës së Posaçme që të refuzojë ankesën si të papranueshme dhe/ose të pabazuar, dhe të vërtetojë (lë në fuqi) Vendimin e Autoritetit të Likuidimit GJI109-0042 të datës 18 korrik 2013.

DHPGJS me aktgjykimin e saj C-IV.-13-1696 të dt.08 mars 2021, e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e ankuesit dhe e ka vërtetuar vendimin e AL. Brenda afatit ligjor pala e pa kënaqur ka paraqitur ankesë dhe Kolegji i Apelit me aktvendimin AC-I.-21-0212-A0001 të dt.28 prill 2022

e ka aprovuar si të bazuar ankesën e paditësit dhe e ka anuluar vendimin e shkallës së parë duke e kthyer lëndën në rigjykim të shkalla e parë.

Gjykata duke vepruar sipas rekomandimeve të Kolegjit të Apelit me dt.23 shtator 2024 ka lëshuar një urdher për të dyja palët ndërgjyqësore duke kërkuar nga të njëjtat që të bëjnë dorëzimin e provave të cilat i posedojnë lidhur me kontestin e kësaj procedure. Paditësit gjykata ka provuar që të ia dorëzoj urdhrin me dt.15 shtator 2024 por zyrtari i postes kishte konstatuar “pala është shpërngulur”. Pastaj, gjykata ka vendosur që të vendos shënim zyrtar dhe e njëjta është vendosur në tabelën e shpalljes nga dt.27 shtator 2024 dhe dt.04 tetor 2024. Kurse e paditura AKP e ka pranuar urdhrin, dhe me dt.14 tetor 2024, i është drejtuar gjykatës me parashtresë ka bërë dorëzimin e Formularit të kërkesës për likuidim, Vërtetimit nr.205 dt.21 shtator 2005, Kopjen e vendimit nr.GJI109-0042 dt.18 shtator 2013, kopjen e urdhrin të dt.15 maj 2014, Kopjen e kërkesës për rishqyrtim të vendimit dt.26.08.2013, Kopjen e librezës së mirëqenjës sociale, Kopjen e njoftimit për ndërpreje të marrëdhënies së punës, Kopjen e aktvendimit për pushim vjetor të punëtorit, Kopjen e kontratës së punës, Kopjen e kërkesës për lirim nga taksa gjyqësore, Kopjen e vendimit C.Nr.114/13 dt.22.08.2013, Kopjen e kundërpërgjigjes së AKP dt.09.09.2014, Kopjen e aktgjykimit C-IV.-13-1696 dt.08.03.2021, Kopjen e përgjigjes ndaj apelit dt.28.03.2022, Kopjen e ankesës së ankuesit dt.30.03.2021, Kopja e aktvendimit të Kolegjit të Apelit AC-I.-21-0212-A0001 dt.28.04.2022.

Arsyetimi ligjor

Ankesa aprovohet si pjesërisht e bazuar.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 par.2 i Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se “pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtresat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese)”, ndërsa dispozita e nenit 42 par.3 parasheh se “pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë”.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen

faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Neni 14 par.1 i Rregullores së UNMIK- ut 2001/27 (si ligj në fuqi në kohën e ofrimit të shërbimeve të punës) parasheh që: “*Pagat - rrogat paguhen: (a) të paktën çdo muaj; (b) punonjësit personalisht ose përmes transferit bankar dhe (c) të shoqëruara me dëftesën e pagesës*”. Neni 55 par.1 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit) parasheh që: “*I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit*”.

Gjykata vlerëson se, për kohën kur pretendohet se është krijuar detyrimi, duhet të aplikohet parashkrimi i përgjithshëm për detyrimet civile lidhur me kërkesat periodike. Këto rregulla gjinden në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) nr. 690 të datës 30 mars 1978, të njëjtat rregulla gjinden edhe në Ligjin nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) i cili ka hyrë në fuqi më 19 dhjetor 2012. Në pajtim me nenin 372, paragrafi 1 i LMD-së, parashkrimi i kërkesave periodike siç është paga, është tri (3) vjet; Ligji i ri ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vitesh (neni 353, paragrafi 1, i LMD-së). Po ashtu, Ligji i Punës nr. 03/L-212 i cili është në fuqi, nuk parasheh dispozitë të veçantë për parashkrimin në lidhje me pagesat e të ardhurave, por parasheh një afat të përgjithshëm prej 3 viteve të parashkrimit, në lidhje me kërkesat që lindin nga marrëdhënia e punës. Nga dispozitat e lartcekura, gjykata vlerëson se parashkrimi si institut i së drejtës civile në përgjithësi dhe në veçanti afati 3 vjeçar i parashkrimit për kërkesat monetare, është ruajtur në të gjitha ligjet që kanë qenë të aplikuara në atë kohë, por edhe në ligjet që tani janë në fuqi.

Prandaj, shihet se parashkrimi për pagat e papaguara të kërkuara në këtë lëndë (pagat për periudhën shtator – dhjetor 2002, janar – mars 2003, prill – dhjetor 2004 si dhe janar – shtator 2005) ishte i rregulluar me LMD-në (1978), i cili ishte ligj ende në fuqi në atë kohë. Vetëm në dhjetor 2012 ligji i aplikueshëm ndryshoi, por edhe LMD-ja ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vjetësh.

Me vjetërsim/parashkrim, ligjërisht shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit, parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i NSH “Kosovatrans”. Në këtë çështje, kontestuese ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim për pagat e papaguara për periudhën e lartëcekur. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. Ankuesi e kundërshton një pretendim të tillë duke u bazuar në Kopjen e vendimit të Autoritetit të Likuidimit GJI109-0042 i datës 18 korrik 2013; Kopjen e kartelës për ndihmë sociale; Kopjen e njoftimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 24 mars 2006; Kopjen e vendimit të Agjencisë për Ndhmi Juridike Falas nr. 114/13 të datës 22 gusht 2013; Kopjen e aktvendimit

për pushim vjetor të datës 24 mars 2003; Kopjen e kontratës si punës nr.179 të dt.12 qershor 2002; Kopjen e kërkesës për lirim nga taksa e parashtruar nga Agjencia për Ndhimi Juridike Falas dt.22 gusht 2013, Kopjen e Formularit me kërkesë për pagat e papaguara, Kopjen e Vërtetimit të NSH-së për pagat e papaguara.

Nga provat e parashtruara nga ankuesi, vërtetohet fakti se ankuesi kishte paga të papaguara nga NSH në shumë prej 2,656.68€. Andaj, gjykata e pranon si provë relevante dhe të bazuara provat tjera të parashtruara nga ankuesi se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhet në vërtetimin e lëshuar nga NSH-ja.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit por, të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar në tërësi, nuk është i saktë. Ankuesi kishte dorëzuar një kërkesë brenda afateve pranë AL me dt.07 shtator 2006. Gjykata vlerëson se, parashkrimi është ndërprerë me njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës të dt.24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa në tërësi është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore. Ankuesit iu kishin parashkruar vetëm pagat e pa paguara për periudhën kohore shtator – dhjetor 2002 si dhe janar – shkurt 2003. Ashtu që duke filluar nga muaji mars 2003 e deri me shtator 2005 ankuesit i takon e drejta e realizimit të pagave të pa paguara pasi që parashkrimi për këtë periudhë kohore është ndërprerë me Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës të dt.24 mars 2006.

Gjykata vëren se njoftimi i dt.24 mars 2006 është pranim i borxhit nga N.SH dhe se parashkrimi ndërpritet me çdo pranim borxhi nga debitori. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kështu ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të saj kreditore në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund ti atribuohet ankuesit dhe kështu ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditore që mund ti ketë duhet ti parashtrorë kur të fillojë procedura e likuidimit. Njëherit një interpretim i tillë është në pajtim edhe me precedentët e DHPGJS-së dhe të Kolegjit të Ankesave (AC-I-20-0282, AC-I-20-0033, AC-I-20-0168, AC-I-20-0183 etj).

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH-ja i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata ia aprovoj shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke u bazuar në muajt për të cilët ankuesi nuk ishte paguar dhe kishte ofruar shërbime për N.SH-në, ashtu që duke filluar nga muaji shtator – dhjetor 2002, janar - mars 2003, prill – dhjetor 2004 si dhe janar – shtator 2005. ankuesit për 77 muaj do ti takonte shuma 2,565.68 €, ashtu siç specifikohet në listën e pagave, por gjykata gjeti se kërkesëpadia e ankuesit duhet të aprovohet pjesërisht për faktin se ankuesit

i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës me dt.24 mars 2006 dhe siç e parashohin dispozitat në fuqi të asaj kohe kërkesat nga marrëdhënia e punës parashkruhen në afat prej tri viteve. Bazuar në këto dispozita ligjore gjykata gjen se kërkesëpadia e ankuesit duhet të aprovohet pjesërisht dhe atë nga muaji marsi i vitit 2003 e deri në muajin shtator 2005, në shumë të përgjithshme prej 1,911.65€.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Ankuesi lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore, ngase kërkesa e të njëjtit për lirim nga taksa gjyqësore është aprovuar me aktgjykimin C-IV.-13-1696 dt.08.03.2021, në përputhje me nenin 8.3.2 të Udhëzimit Administrativ të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r i,
Dr.sc.Murat Hulaj